



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 2, datë 27.01.2025**

**MBI  
FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2025**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 35 e vijues të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 35, pika 7, të Ligjit nr. 32, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Byroja Shqiptare e Sigurimit kryen funksionet e entit kompensues për kryerjen e pagesave të dëmeve të parashikuara në nenin 41 të këtij ligji dhe kontributet e nevojshme për pagesën e këtyre dëmeve përballohen nga Fondi i Kompensimit.

Në zbatim të nenit 41, pika 4, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti, me propozimin e Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Fondit të Kompensimit.

Gjithashtu, në bazë të nenit 40, të Ligjit nr. 32/2021, shoqëritë e sigurimit krijojnë dhe mbajnë provigjonet e dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 41, të këtij ligji.

Byroja me shkresën nr. 72 prot., datë 10.01.2025, protokolluar me tonën nr. 80 prot., datë 10.01.2025, depozitoi në Autoritet vendimin nr. 23, datë 30.12.2024 “Për miratimin e masës së kontributit për fondin e kompensimit për vitin 2025”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Masa e kontributit për fondin e kompensimit për vitin 2025, të jetë në vlerën 250,000,000 lekë.
2. Provigjonet e dëmeve të fondit të kompensimit për rastet e përcaktuara në nenin 41, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të krijohen në vlerën prej 552,133,652 lekë, të cilat do të pasqyrohen nga shoqëritë e sigurimit, në pasqyrat financiare të vitit 2024.
3. Byroja Shqiptare e Sigurimit:
  - 3.1. Të llogaritet dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të fondit të kompensimit sipas pikës 1, të këtij vendimi;
  - 3.2. Të llogaritet dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive për krijimin e provigjonit për shpenzime sipas pikës 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen departamentet përkatëse, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**